



**Raport përfundimtar për auditimin tematik “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË  
MINISTRINË E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT,  
INSPEKTORATIN SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT DHE  
AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
ME OBJEKT,  
“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA  
NË AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË “GARANTIMI I MBROJTJES  
SË TË DREJTËS SË AUTORIT”**

**PRILL 2025**

## PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:.....	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh.....	3
3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.....	4
4. Statusi i pranimit të rekomandimeve.....	4
II. HYRJA.....	5
II.1 Objekti auditimit:.....	5
II.2 Qëllimi auditimit.....	5
II.3 Metodologjia e auditimit:	5
II.4 Konkluzioni.....	5
II.5 Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.....	7
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	7
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	22
V. ANEKSE.....	26

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 1479 prot, datë 12.12.2024, me objekt, "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë: "Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit", evaduar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023", ushtri auditim tematik në 3 (tre) subjektet pjesë e Auditimit të Performancës me temë: "Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit", përkatësisht: Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 215 datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të auditimit me shkresat me nr. 445/15,14,19 prot., datë 19.12.2023.

Auditimi u krye nga data 16.12.2024 deri më datë 17.01.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara përkatësisht MEKI, ISHMT dhe AMA u mbajtën Akt-Verifikimet të cilat janë regjistruar përkatësisht:

-Në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Akt-Verifikimi nr. 1 datë 16.01.2025.

-Në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Akt-Verifikimi nr. 2 datë 16.01.2025.

-Në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Akt-Verifikimi nr. 3 datë 16.01.2025.

Projektraporti u është dërguar subjekteve me shkresat 1479/6 MEKIT, 1479/7 ISHMT dhe 1479//8 AMA datë 17.02.2025.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga auditimi u rezultoi se:

-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka dërguar me shkresën nr. 4796, prot., datë 12.04.2024, planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së, protokolluar me tonën me nr. 445/19, prot., datë 16.04.2024, pasi Drejtoria e të Drejtës së Autorit ka marrë dijeni për raportin e KLSH-së, përmes postës elektronike më datë 21.3.2024 ora 12:22, nga zyra e protokollit të institucionit në format pdf. Gjithashtu, DDA është njoftuar përmes postës elektronike më datë 12.4.2024, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për dhënien e informacionit në lidhje me planin e veprimit të miratuar për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të performancës. DDA përmes postës elektronike më datë 12.4.2024, ka kthyer përgjigje Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, se materiali është në proces përgatitjeje dhe do të përcillet një kopje e tij e protokolluar menjëherë sapo të marrim dijeni nga protokollu i MEKI në formë zyrtare.

- Përmes shkresës nr. 4796 prot., datë 12.4.2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka dërguar programin e përgatitur për zbatimin e rekomandimeve, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, ka dërguar me shkresën nr. 1419/14 prot., datë 12.01.2024 planin e masave paraprak për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së, protokolluar me tonën me nr. 445/18, datë 15.01.2024, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.
- Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,** për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk ka dërguar raportimin 6 mujor në KLSH, në respektim të afatit ligjor mbi zbatimin e rekomandimeve.

-Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, nuk kanë dërguar raportimin 6 mujor në KLSH, në respektim të afatit ligjor mbi zbatimin e rekomandimeve.

#### **4. Statusi i pranimit të rekomandimeve**

KLSH ka dërguar:

-në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me shkresën nr. 445/15, datë 19.12.2023

-në Autoritetin e Mediave Audiovizive, me shkresën nr. 445/14, datë 19.12.2023

-në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me shkresën nr. 445/19, datë 19.12.2023

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”.

Në këtë auditim, me shkresat e sipërcituara, KLSH ka rekomanduar 16 masa, nga të cilat 3 masa “Propozime për ndryshime ligjore” dhe 13 “Masa organizative” për zbatim. Nga 16 masat e rekomanduara, nga subjektet, janë pranuar 16 masa ose 100 % e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	3	3	0
2	Organizative	13	13	0

## **II. HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 1479 prot., datë 12.12.2024. Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr. 215 datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 445/15 prot., nr. 445/14 dhe nr. 445/19 prot., datë 19.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. M. L., përgjegjëse grupi
2. A. S., anëtar
3. J. Zh., anëtare
4. Sh. H. anëtar

Auditimi ka filluar më, 16.12.2024

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025

### **II.1. Objekti i auditimit:**

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, për auditimin e performancës me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”.

### **II.2. Qëllimi i auditimit:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **II.3. Metodologjia e auditimit:**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

### **II.4. Konkluzioni:**

Në tre subjektet e audituar rezultoi që në dy prej tyre, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, ndërsa nga Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh në zbatim të ligjit të sipërcituar.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive kanë dërguar planin e masave përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, por nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 muaj, afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara në pikën I/4 të këtij Raporti, rezulton se: -Nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa ose në masën 100%.

Nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 4 ose 25 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 4 masa ose 25 % e tyre, në proces zbatimi 6 masa ose 38 % e tyre dhe pa zbatuara 2 masa ose 12 % e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësime ligjore	3		1	2	
2	Organizative	13	4	3	4	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>2</b>

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave Për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	3	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	3	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	0	0
2	Zbatuar pjesërisht	1	33%
3	Në proces zbatimi	2	67%
4	Pa zbatuar		

Nr.	Statusi i masave Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	13	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	13	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	4	31%
2	Zbatuar pjesërisht	3	24%
3	Në proces zbatimi	4	31%
4	Pa zbatuar	2	14%

### II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 25 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi dhe zbatuar pjesërisht niveli i tyre shkon në 87.5 %.

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

## A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

### 1. Për pyetjen e auditimit: A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?

**2. Gjetje nga auditimi:** Kuadri rregullator për të drejtën e autorit<sup>1</sup>, nuk është përafuar me direktivat e BE-së<sup>2</sup>:

- Ministria e Kulturës, nuk ka propozuar hartimin e marrëveshjeve në fushën e të drejtës së autorit lidhur me Aderimin në dy traktate, Traktatin e Marakeshit “Për personat me dëmtime në shikim”, planifikuar për vitin 2017 dhe Traktatin e Pekinit “Mbi veprat audiovizuale”<sup>3</sup>, planifikuar për vitin 2018.

-Ka përafuar pjesërisht 2 direktivat të BE-së lidhur me, koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore dhe për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi - territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm.

**2.1 Gjetje nga auditimi:** Kriteret e vendosura në pikën 1 të nenit 135 të ligjit krijojnë kushte për monopolizim të tregut, duke u bërë pengesë për hyrjen në treg të agjencive të reja. Një shoqatë përfaqësuese autorësh e cila plotëson më mirë kushtet e nenit 133 të ligjit për të qenë e licencuar si agjenci administrimi kolektiv, mund të mos plotësojë kushtet e nenit 135 të ligjit, meqë nuk kanë arritur akoma një bashkëpunim me agjencitë simotra.

**2.2 Gjetje nga auditimi:** Referuar pikës 6, të nenit 151 të Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, lidhur me llogaritjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve, vlerësohet se ka boshllëk ligjor, pasi nuk përcaktohet afati kohor i shpërndarjes. Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve së paku një herë në vit nga AAK-të ka sjellë problematika lidhur me këtë proces.

**2.3 Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit nuk kanë miratuar/hartuar aktet nënligjore për të drejtat e autorit, brenda afateve ligjore të përcaktuara. Në mungesë të tyre, aktiviteti i drejtorisë përgjegjëse është jo efektiv.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masat për miratimin e akteve nënligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian për:

-rishikimin e llogaritjes dhe shpërndarjes së shpërblimeve duke përcaktuar një afat të përshtatshëm për shpërndarjen e tyre;

-krijimin e bazës së të dhënave dhe elementët e regjistrit për të drejtën e autorit, për kompensimin e veprave pa autor, si dhe udhëzimin për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtarinë e sportelit unik;

-rishikimin e kriterëve të përfaqësimit për administrimin e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut.

**Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë për miratimin e akteve nënligjore në përputhje me direktivat e BE-së shprehen se:

a) DDA ka marrë masat për hartimin e draft-ligjit të ri në fushën e të drejtës së autorit, në të cilin, ndër të tjera do të përcaktohet edhe rishikimi i llogaritjes dhe shpërndarjes së shpërblimeve duke përcaktuar një

<sup>1</sup> Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

<sup>2</sup> Direktivën (BE) 2019/789 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 prill 2019 dhe Direktivën (BE) 2019/790 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 17 prill 2019.

<sup>3</sup> SKPI 2016-2020 fq. 21

afat të përshtatshëm për shpërndarjen e tyre sipas praktikave më të mira në rajon dhe më gjerë, si dhe rishikimi i kriterëve të përfaqësimit për administrimin e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut. (Neni 34 i projektligjit, i cili ndryshon pikën 6 të nenit 151 të ligjit në fuqi). Projektligji, është planifikuar për konsultim publik në muajin janar 2025.

b) Përveç kësaj, është miratuar baza ligjore nëpërmjet vendimit nr. 651, datë 22.11.2023, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”” dhe përcaktimin e elementeve të regjistrimit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar dhe elektronik”.

c) Është miratuar vendimi nr. 629 prot., datë 8.11.2023 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”.

d) Ministri përgjegjës për të drejtat e autorit ka miratuar udhëzimin nr. 777, datë 24.11.2023 "Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Sportelit unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të së drejtës së autorit".

e) Në lidhje me "rishikimin e kriterëve të përfaqësimit për administrimin e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut", DDA po shqyrton mundësinë për propozime ligjore për licencimin e disa agjencive të administrimit kolektiv në RSH. Në projektligj po vlerësohet mundësia që administrimi kolektiv i të drejtave me të njëjtën kategori të mbajtësve të së drejtës, t'i jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit më tepër se një subjekti të cilët plotësojnë kriteret në bazë të kontratave respektive me mbajtësit e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut. Ky model lejon që më shumë se një agjenci të licencohet, duke i dhënë mbajtësve të së drejtave zgjedhjen për të bashkëpunuar me agjencinë që i përshtatet më mirë.

Ky sistem paraqet avantazhet si vijon:

-Konkurrencë më e madhe për agjencitë që garojnë për të ofruar shërbime më të mira dhe tarifa më të ulëta;  
-Më shumë opsione për mbajtësit e të drejtave si autorët, artistët dhe krijuesit të kenë më shumë mundësi për të zgjedhur;

-Ulja e mundësisë për monopolizim të tregut;

-Rritja e përgjegjësisë për AAK-të.

Disavantazhet:

-Përdoruesit dhe mbajtësit e të drejtave mund të përballen me konfuzion në rast se ka agjenci të shumta;

-Monitorim më i vështirë i veprimtarisë financiare dhe administrative;

-Rriten shpenzimet financiare.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi**. Referuar në sa më sipër, nga ana e MEKI janë zhvilluar disa takime, por ndryshimet përfshijnë disa grupe interesi, të cilat duhet të shprehen lidhur me ndryshimet e mësipërme ligjore.

### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Legjislacioni aktual për të drejtën e autorit krijon kushte për mbivendosje kompetencash, lidhur me monitorimin/ inspektimin dhe zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to sepse nga institucionet përgjegjëse nuk janë propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore mbi procedurat e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet ex-officio (në terren), inspektimet për tregtimin on line, procedurat e bllokimit dhe shkatërrimit të mallrave pirate dhe të falsifikuara, koordinimin ndërinstucional duke rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit, ku të përcaktohen fushat e përgjegjësisë dhe të kompetencave përkatëse.

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive, të marrin masat për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe të rishikojnë/nënshkruajnë marrëveshjet e bashkëpunimit, lidhur me garantimin e mbrojtjes të së drejtës së autorit.

**Menjëherë**

#### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë për marrjen e masave për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, shprehet se: Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) ka si objekt të veprimtarisë së tij përveç të tjerash, inspektimin dhe monitorimin e tregut të brendshëm dhe konstatimin e rasteve të shkeljeve për operatorët ekonomikë që kryejnë kundërvajtje administrative në bazë të nenit 179 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive. Ky institucion ka si objekt të veprimtarisë së tij përveç të tjerash, mbrojtjen dhe monitorimin e të drejtave të autorit nga ana e ofruesve të shërbimit mediatik. Në rast të mosrespektimit të kushteve dhe afateve për të cilin i licencuari ose i autorizuari ka nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të veprave të transmetuara prej tij, AMA vendos sanksione me gjobë ose heqjen e licencës.

Për sa më sipër, institucionet për mbrojtjen e të drejtave të autorit janë të përcaktuara sipas ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, si dhe nuk vlerësohet se ka përplasje të kompetencave. Krahas kësaj, nuk janë raportuar raste të kësaj natyre.

Megjithatë, në projektligjin për të drejtën e autorit përcaktohet ndarja e kompetencave në lidhje me të drejtën e autorit në fushën digjitale, mbrojtjen dhe marrjen e masave në rast të shkeljes së ligjit për të drejtën e autorit.

Aktualisht, janë zhvilluar 2 (dy) mbledhje me AMA në lidhje me këtë problematikë, përkatësisht në datën 26 nëntor 2024 dhe online në datën 20.12.2024.

Në vijim është kërkuar përsëri nga DDA të zhvillohen mbledhje për rekomandimin e KLSH-së dhe trajtimin e tij, si dhe është përcaktuar fillimi i vitit 2025 si datë e mundshme për shqyrtimin e tij.

#### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

ISHMT në vlerësim të rekomandimit të lënë për marrjen e masave për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, shprehet se:

Në shkresën me nr. 1419/14, datë:12.01.2024 të ISHMT drejtuar KLSH-së, me lëndë: “Përgjigje për Rekomandime sipas Raportit Përfundimtar për auditimin e performancës me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, nr. 445/16 prot., datë 19.12.2024”, përcaktohen personat që do të jenë në grupin ndërinstytucional të punës për ndryshimet ligjore.

AMA në vlerësim të rekomandimit të lënë për marrjen e masave për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, shprehet se: Aktualisht ISHMT dhe AMA janë duke shqyrtuar hapësirat ligjore dhe institucionale për draftimin e një Memorandumi Bashkëpunimi midis dy institucioneve. Propozimit për nënshkrimin e këtij Memorandumi i jemi përgjigjur institucionalisht duke vlerësuar piketat e këtij bashkëpunimi dhe vijimësinë sipas korespondencës bashkëlidhur këtij komenti.

AMA i ka kërkuar ISHMT një takim paraprak për të diskutuar më specifikisht detajet e propozimit dhe për të siguruar që të dyja palët janë të qarta mbi angazhimet dhe detyrimet që mund të lindin nga ky bashkëpunim.

Fillimi i vitit 2025 do të jetë dhe incimi faktik ndërinstytucional i cili do të vijojë me nënshkrimin e marrëveshjes së mirkuptimit midis dy institucioneve.

## **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i **pranuar, në proces zbatimi**.

### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar se, që nga viti 2017, nuk ka një marrëveshje gjithëpërfshirëse të përditësuar, midis shoqatave të përdoruesve dhe agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit. Procesi i negocimit për arritjen e saj ka dështuar, dhe nuk ka asnjë kërkesë nga aktorët e legjitimuar, pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtën Autorit, për rishikimin e metodologjisë dhe masës së shpërblimit të tarifave për mbajtësit e të drejtave. Kuadri ligjor aktual, nuk ofron asnjë mekanizëm për zgjidhjen e këtij ngërçi.

**4.1 Gjetje nga auditimi:**Neni 146 i Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, është në kundërshtim me aktet ligjore, sepse:

- tarifat e shërbimeve nuk përcaktohen me urdhër ministri, por me akte nënligjore të niveleve më të larta;
- sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 27.06.2012, i ndryshuar, anëtarët e KKDA marrin shpërblim për çdo mbledhje.
- KKDA gjatë periudhës 2019-2022 ka zhvilluar vetëm dy mbledhje, në moszbatim të detyrimit ligjor.

**4.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të propozojë, rishikimin e akteve nënligjore lidhur me mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, si dhe krijimin e një mekanizmi për ndërhyrjen e tij në procesin e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit.

**Menjëherë**

## **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vlerësim të rekomandimit të lënë për rishikimin e akteve nënligjore për funksionimin dhe organizimin e KKDA-së ka propozuar aktin nënligjor, i cili është miratuar me vendimin nr. 737, datë 27.11.2024 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 35, datë 18.1.2017 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)".

## **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si **të pranuar dhe pjesërisht i zbatuar**, pasi me krijimin e KKDA-së duhet të krijohet dhe mekanizmi për ndërhyrjen e tij në procesin e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit.

### **Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

### **1. Për pyetjen e auditimit: A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2020-2022 nuk ka pasur strategji kombëtare, për të drejtën e autorit. Statusi që i jepet Drejtorisë së të Drejtës së Autorit nga Strategjitet e Pronësisë Intelektuale, nuk është në raport me përcaktimet e bëra nga ligji, mbi rolin dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie, sepse e trajton këtë drejtori si një institucion dytësor për nga rëndësia.

-DDA-ja nuk harton një strategji të vetën, të dedikuar për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe garantimi i

kësaj të drejte nuk parashikohet as në Strategjinë e Ministrisë së Kulturës, duke lënë jashtë fokusit të saj, rolin dhe përgjegjësinë e saj.

Propozimi për bashkimin e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale, nuk lidhet me objektin e aktivitetit të DDA-së, për faktin se veprimtaria funksionale e kësaj drejtorie, është e drejta e autorit.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës si institucion përgjegjës në fushën e të drejtës së autorit, të krijojë një grup pune për rishikimin e dokumenteve politikë si dhe vlerësimin e mundësisë së hartimit të një strategjie të dedikuar për të drejtën e autorit, sipas ligjit që e sanksionon këtë të drejtë.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë mbi rishikimin e dokumenteve politikë ka vlerësuar se Drejtoria e të Drejtës së Autorit aktualisht është hartuese dhe zbatuese e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025. Në kuptimin e gjerë “Pronësia Intelektuale” mund të përkufizohet si e drejta ligjore mbi krijimtarinë intelektuale. Gjithashtu, në kuadër të Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, në kapitujt e acquis si pjesë e tyre është edhe Kapitulli 7 “E Drejta e Pronësisë Intelektuale”. Acquis mbi pronësinë intelektuale parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë industriale.

Në strategjinë e sipërpërmendur janë pjesë institucionet për përmbushjen e qëllimit, përkatësisht si vijon:  
Institucionet lider:

Pronësia Industriale - Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);

E drejta e Autorit - Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA);

Institucionet mbështetëse:

Drejtoria e Policisë së Shtetit;

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;

Shkolla e Magjistraturës;

Autoriteti i Mediave Audiovizive;

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit;

Ministria e Drejtësisë;

Universiteti Politeknik i Tiranës;

Prokuroria;

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

Autoriteti i Konkurrencës;

Dhomat e Tregtisë / Unioni i Dhomave të Tregtisë/ Dhoma Amerikane e Tregtisë;

Agjencia e Kërkimit Teknologjisë së Inovacionit;

Avokatët dhe Përfaqësuesit e Autorizuar.

Për sa më sipër, është e rëndësishme të theksojmë që DDA deri në vitin 2027 është pjesë e një strategjie kombëtare dhe ka kontribut kryesor hartimin e një strategjie të pavarur për të drejtën e autorit, në të njëjtën kohë është një mbivendosje e planifikimeve të objektivave mbi të cilat jepet kontribut në strategjinë aktuale në fuqi.

Megjithatë në vitin 2025, përpara përfundimit të afatit të strategjisë në fuqi, i cili është i rëndësishëm në fushën e pronësisë intelektuale, do të vlerësohet hartimi i një strategjie të dedikuar për të drejtën e autorit. Drejtoria për të Drejtën e Autorit ka kërkuar asistencë nga projekti ALSIP për të marrë asistencë të huaj për hartimin e një strategjie të vetme në fushën e të drejtës së autorit.

Planifikimi konkret:

- Shqyrtimi i nevojës për të hartuar një strategji të veçantë dhe evidentimi i fushave të prioriteteve - Janar 2025;
- Asistencë nga një ekspert për hartimin e draft strategjisë për të drejtën e autorit - Maj 2025;
- Miratimi i strategjisë për vitet 2026 - 2027 – Dhjetor 2025 /Janar 2026.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si **të pranuar dhe pjesërisht i zbatuar**, pasi MEKI ka kërkuar nga projekti ALSIP për të marrë asistencë të huaj për hartimin e një strategjie të vetme në fushën e të drejtës së autorit.

### **Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2019-2022, DDA-ja ka hartuar vetëm një plan pune në të cilin përcaktohen aktivitetet dhe veprimtaritë e ndryshme të cilat kanë për qëllim edukimin e brezave dhe të shoqërisë në tërësi, mbi rëndësinë e të drejtës së autorit. Dhe pse, në SKPI-të janë parashikuar fushatat ndërgjegjësuëse, kjo është e pamundur të realizohet, për shkak të mungesës së fondeve.

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në bashkëpunim me grupet e interesit të ndërmarrë iniciativa për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorëve të veprave dhe rëndësinë e kësaj të drejte në ekonominë e vendit.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me të drejtën e autorit shprehet se:

a) DDA ka zhvilluar aktivitete, iniciativa për përmbushjen e qëllimit për rritjen e ndërgjegjësimit, ku mund të përmendim si vijon:

- Me bashkëpunimin e Organizatës Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (OBPI) dhe projektin Shqiptaro – Zvicëran (ALSIP), janë riprodhuar dhe shpërndarë në gjuhën shqipe për vitin 2024, botime të OBPI për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe praktikant më të mira të agjencive të administrimit kolektiv.

- Bashkëpunimi midis grupeve të interesit për konkretizimin e ndryshimeve në metodologjinë e tarifave. Drejtoria e të Drejtës së Autorit me angazhimin e saj me strukturat e OBPI dhe projektin ALSIP, ka organizuar në datat 8-9 prill 2024 takime të grupeve të interesit dhe ekspertë të fushës, kombëtar dhe ndërkombëtar për hartimin e metodologjisë së tarifave. Në takim ishin pjesëmarrës grupet e interesit si Sporteli unik, përfaqësues nga OSHMAT-të, agjencitë e administrimit kolektiv si dhe shoqata të përfaqësuesve hoteleve dhe subjekteve të tjerë përdorues dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit.

- DDA si grup interesi për të drejtën e autorit, ka zhvilluar më datë 22 Tetor 2024 një aktivitet në formë dialogu, në bashkëpunim me ALSIP, në lidhje me iniciativat në këtë fushë, vështirësitë për realizimin e projekteve, situatën aktuale të proceseve të ndryshme, bashkëpunimin e ndërsjellë dhe prioritetet në vijim.

- Takim i realizuar për vendosjen në qendër të grupeve të interesit dhe transparencën e punës së DDA-së, nëpërmjet bashkëpunimit me projektin Shqiptaro – Zvicëran në fushën e pronësisë intelektuale ALSIP. Implementimin e të drejtës së huadhënies publike (PLR) e cila ka një kontribut të rëndësishëm në diversitetin gjuhësor dhe kulturor duke ofruar mbështetje të nevojshme për autorët që shkruajnë në gjuhë pakicash. Drejtoria e të Drejtës së Autorit ka zhvilluar më datë 11 Nëntor 2024, një takim, në bashkëpunim me OBPI, në lidhje me përcaktimin e tarifave për Huadhënien Publike. Pjesëmarrës në këtë takim ishin dhe përfaqësues nga Biblioteka Publike dhe Bibliotekave të menaxhuara nga Bashkia.

- Janë zhvilluar trajnime për bizneset e reja, në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

- Workshop me pjesëmarrje të magistraturës, me panel përfaqësues të DDA, DPPI, gjyqtarë të

Gjykatës Kushtetues dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

a) Bazuar në Raportin për Vlerësimin e Kapaciteteve të Institucioneve të Përfshira në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) sipas Kornizës së Përbashkët Metodologjike për Vlerësimin e Kapaciteteve dhe Strukturave të Integritimit Evropian (CAF) për DDA është miratuar një strukturë e veçantë e cila ka kompetencën kryesore lidhur me ndërgjegjësimin për garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorëve të veprave dhe rëndësinë e kësaj të drejte në ekonominë e vendit.

b) Në vijim, DDA në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale ka bërë planifikimin për vitin 2025:

- Ndërgjegjësim në lidhje me fushën digjitale, organizimi i një konference ndërkombëtare në lidhje me zbatimin e të drejtave të autorit në fushën digjitale.
- Takime informuese në lidhje me institucionet e veçanta dhe në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe të drejtën e autorit.
- Zhvillimi i një studimi në lidhje me impaktin e të drejtës së autorit në fushën ekonomike, kulturore dhe sociale.
- Gjithashtu, DDA në muajin dhjetor do të hartojë planifikimin për rritjen e ndërgjegjësimit me asistencën e projektit ALSIP.

Së fundi, po bashkëpunohet me Delegacionin e Bashkimit Evropian për një projekt “Twining light” në lidhje me ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve për të drejtën e autorit në fushën digjitale, për të gjithë grupet e interesit.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

### **Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

#### **2. Për pyetjen e auditimit: A ka qenë efektiv procesi i administrimit të së drejtës së autorit?**

##### **2.1 Për nënpyetjen: Si ka funksionuar mekanizmi i ngritur për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës ka rilicencuar agjencinë e administrimit kolektiv “A”, në muajin gusht të vitit 2021, pa evidentuar shlyerjen e detyrimeve financiare prej 6,7 milion lekë të kësaj agjencie në fondin special të Ministrisë së Kulturës, kusht detyrues në Urdhrin<sup>4</sup> e ministrit “Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A”. Nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit pranë kësaj ministrie, nuk dokumentohet shlyerja e këtij detyrimi financiar.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar detyrimet e prapambetura financiare të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve duke plotësuar një databazë të dhënash financiare.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Drejtoria e të Drejtës së Autorit ka përfunduar procedurën e monitorimit të agjencive të administrimit kolektiv për vitin financiar 2023. Raporti përfundimtar përmban tabelat për të dhënat financiare. Përkatësisht:

<sup>4</sup> Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”A” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve tveprave artistike dhe letrare”

- të ardhurat;
- shpërndarjet;
- shpenzimet;
- shpërblimet e pa shpërndara.

Në përfundim të monitorimit, bazuar në rekomandimet dhe konkluzionet e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, agjencitë e administrimit kolektiv kanë përcjellë përgjigjet e tyre së bashku me informacionet në lidhje me shumatat e pashpërndara, të cilat janë paraqitur në një material të përmbledhur bashkëlidhur.

Përsa i përket shpërblimeve të pashpërndara në përfundim të vitit financiar, në draft-ligjin e ri është parashikuar se “Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve bëhen të paktën një herë në vit por jo më vonë se 9 muaj pas përfundimit të vitit financiar kur janë bledhur të ardhurat.”. Është zgjatur afati i shpërndarjes së shpërblimeve në përputhje me direktivën 2014/26/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26.2.2014 "Për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, dhe licencimin shumë territorial të të drejtave për veprat muzikore për përdorim përmes internetit në tregun e brendshëm".

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

**Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**1.2 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit të marrë masa t’i kërkojë Agjencisë së Administrimit Kolektiv “A”, dokumentimin e shlyerjes së detyrimit financiar prej 6,7 milion lekë që i takon mbajtësve të të drejtave të autorit, të përcaktuar në Urdhrin<sup>5</sup> e ministrit “Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A”.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë për dokumentimin e shlyerjes së detyrimeve financiare prej 6,7 milion lekë nga Agjencia e Administrimit Kolektiv “A”, në fondin special të Ministrisë së Kulturës, shprehet se Drejtoria për të Drejtën e Autorit nëpërmjet emailit të datës 2.5.2024 ka kërkuar nga Agjencia e Administrimit Kolektiv “A”, dokumentimin e shlyerjes së detyrimit financiar prej 6,7 milion lekë që i takon mbajtësve të të drejtave të autorit, të përcaktuar në Urdhrin e ministrit “Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A”.

Nëpërmjet shkresës nr. 6011 prot., datë 10.5.2024, agjencia e administrimit kolektiv "A" ka përcjellë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit informacion për shlyerjen e detyrimit financiar të përcaktuar në Urdhrin nr. 432, datë 6.7.2021 i Ministrit të Kulturës "Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë “A” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare".

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës nuk ka çelur një llogari të dedikuar, e cila të përdoret posaçërisht për krijimin e fondit special, ku duhet të depozitohen shumatat e pashpërndara nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, mbajtësve të të drejtave të autorit.

<sup>5</sup> Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë “A” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare”

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të krijojë Fondin Special, ku të depozitohen tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, duke çelur një llogari të dedikuar.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

MEKI në vlerësim të rekomandimit të lënë lidhur me krijimin e Fondit Special shprehet se ngritja e fondit nuk është kompetencë e DDA-së, por kjo e fundit i ka kërkuar Drejtorisë së Financës në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, krijimin e një Fondi Special, ku të depozitohen tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga agjencitë e administrimit kolektiv, duke çelur një llogari të dedikuar. Përkatësisht:

- a) Shkresa nr. 485 prot., datë 01.02.2023;
- b) Email i Drejtorisë për të Drejtën e Autorit drejtuar Drejtorisë së Financës datë 30 shtator 2024;
- c) Zhvilluar takim për këtë problematikë me Drejtorinë e Financës në datën 3 tetor 2024.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i pranuar, në proces zbatimi.

### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në kushtet e ndryshimeve të përfaqësuesve të administrimit të të drejtave të autorit, aktorëve të përfshirë, numrit të shtuar të përdoruesve, kategorive të të drejtave të paparashikuara më parë, konstatohet se nuk ka pasur një rishikim të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit që nga viti 2017, nga grupet e interesit. Drejtoria për të Drejtën e Autorit, nuk ka bërë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, si dhe nuk ka ndërjegjësuar grupet e interesit mbi rëndësinë e saj.

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të bëjë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të së drejtës së autorit dhe t'a bëjë objekt konsultimi për grupet e interesit.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Drejtoria e të Drejtës së Autorit ka organizuar në bashkëpunim me OBPI dhe ALSIP hartimin e një dokumenti i cili analizon në mënyrë të thelluar bazën ligjore për hartimin e një metodologjie të tarifave dhe procedurës për miratimin e saj.

Fillimisht janë organizuar dhe zhvilluar disa takime në datat 8 – 9 prill 2024 me grupet e interesit dhe ekspertët vendas dhe të huaj të përcaktuar për hartimin e metodologjisë së tarifave me qëllim prezantimin, diskutimin dhe konsultimin mbi metodologjinë e tarifave të shpërblimit. Në vijim, ekspertët, duke marrë në konsideratë edhe qëndrimet gjatë takimeve, kanë draftuar metodologjinë e re.

Për miratimin e metodologjisë së tarifave për përdorimin e të drejtave të autorit është planifikuar:

Së pari, më datë 23 dhjetor 2024 deri në 24 janar drafti i hartuar nga ekspertët do të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për transparencë dhe dhënie mundësisë për çdo subjekt të njihet dhe të bëhet palë në negociatat e lidhjes së marrëveshjes. Gjithashtu, drafti do të përcillet agjencive të administrimit kolektiv dhe përfaqësuesve të shoqatave të përdoruesve që kanë marrë pjesë në takimet me ekspertët e caktuar për hartimin e metodologjisë.

Së dyti, nga data 6 shkurt 2024 deri 6 mars 2025, AAK-të duhet të përfundojnë një marrëveshje me shkrim me përfaqësuesit e shoqatës së përdoruesve të veprave të autorëve mbi repertorin e veprave të tyre.

Së treti, pas përfundimit të afatit si më sipër nuk është miratuar metodologjia me marrëveshje, KKDA-ja do të përcaktojë/vendos një tarifë të përshtatshme në lidhje me marrëveshjen gjithëpërfshirëse. Kohëzgjatja e procedurës përpara KKDA-së do të jetë 45 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

Procedura e përmbledhur sipas afateve:

<b>Procedura</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Data e fillimit</b>	<b>Data e përfundimit</b>
<b>Faza 1:</b> Konsultimi publik.	- Publikimi i draftit të metodologjisë në faqen e internetit. - Konsultimi publik.	23.12.2024	24.01.2025
<b>Faza 2:</b> Negociatat	- Përpunim i të dhënave nga DDA.	27.01.2025	04.02.2025
	- Takim me grupet e interesit.	05.02.2025	05.02.2025
	- Negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes gjithëpërfshirëse.	06.02.2025	06.03.2025
<b>Faza 3:</b> Vendimi i KKDA	- Procedura përpara KKDA-së.		45 ditë nga paraqitja e kërkesës

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

#### **4. Gjetje nga auditimi:** Agjencitë e administrimit kolektiv:

- nuk respektojnë mbajtjen brenda nivelit 30% të kostove të administrimit të të drejtave të autorit, në raport me masën e shpërblimeve të shpërndara tek mbajtësit e këtyre të drejtave;
- kanë realizuar një nivel të ulët të shpërndarjeve të shpërblimeve, tek mbajtësit e të drejtave të autorëve;
- nuk shpërndajnë tarifën e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar, të cilat duhet të depozitohen në një fond special për llogari të Ministrisë të Kulturës, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit për një periudhë 3-vjeçare;
- nuk rishikojnë performancën e përgjithshme të organeve ekzekutive të tyre.

#### **4.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit të propozojë masa administrative për agjencitë e administrimit kolektiv që:

- tejkalojnë kostot e administrimit;
- kanë nivel të ulët shpërndarjesh të shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtës së autorit;
- nuk rishikojnë performancën e aktivitetit të organeve ekzekutive të tyre;
- nuk bëjnë transparente vendimet e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Në përfundim të procedurës së monitorimit të agjencive të administrimit kolektiv për vitin financiar 2023.

Drejtoria e të Drejtës së Autorit ka evidentuar parregullsitë në funksionimin e agjencive, sipas së cilave janë vendosur rekomandimet përkatëse për rregullimin e tyre. Bazuar në rezultatet e raporteve të DDA-së, agjencitë kanë përcjellë shpjegimet dhe masat e marra në kuadër të këtij procesi. Gjithashtu, agjencitë sipas detyrimit në ligj për publikimin e të dhënave në faqen e internetit, kanë publikuar në mënyrë transparente informacione të përditësuara.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezultoi **i pranuar, i zbatuar.**

### **Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

#### **5. Gjetje nga auditimi: SUADA:**

- nuk bën transparente kriteret e zbatuara nga ana e saj mbi përzgjedhjen e subjekteve të cilët njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizimin e të drejtës së autorit;
- gjatë periudhës 2019-2022, ka ngritur 10 akt-padi ndaj shkelësve të së drejtës së autorit, pra me një mesatare prej vetëm 2,5 shkelje të pretenduara të kësaj të drejte në çdo vit.
- mbetet larg objektivit të gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;
- nuk ka realizuar ngritjen e rjetit të zyrave të përfaqësimit, me të paktën një zyrë në çdo qark.

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit t'i kërkojë Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit, të bëjë transparente:

- kriteret e zbatuara nga ana e saj, në përzgjedhjen e subjekteve që njofton zyrtarisht, për t'u pajisur me autorizim;
- mënyrat e gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;
- një analizë mbi mosngritjen e rjetit të zyrave të përfaqësimit nga SUADA-s.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

DDA në zbatim të rekomandimit të KLSH ka kërkuar ndaj Sportelit unik informacion përkatës. Sporteli unik në mënyrë të përmbledhur ka sqaruar si vijon (përgjigja e plotë gjendet bashkëlidhur shkresës):

1. Kriteret e zbatuara nga ana juaj në përzgjedhjen e subjekteve që njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizim për ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- a) Identifikimi i Subjektit dhe aktiviteti ekonomik;
- b) Kategoria e veprave artistike që përdoren duhet të jenë të llojit të muzikës, filmave etj, sipas kategorive të licensimit nga Ministria e Kulturës të Agjencive të Administrimit Kolektiv
- c) Subjektet përzgjidhen duke u bazuar në llojin e aktivitetit të tyre ekonomik si dhe rëndësia që ka përdorimi i veprave të mbrojtura në aktivitetin e tyre;
- d) Prioritizimi i sektorëve me ndikimin më të madh dhe lehtësinë në identifikim;
- e) Subjekte përdoruese që njohin detyrimet ligjore;
- f) Grupet e interesit;
- g) Diversiteti.

2. Mënyrat dhe procedurat që përdorin për gjurmimin dhe denoncimin e shkelësve të së drejtës së autorit, duke përfshirë mekanizmat e ndjekura për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

- a) Monitorimi i aktiviteteve tregtare që përdorin vepra të mbrojtura;
- b) Mbledhja e të dhënave nga palët e interesuara;

3. Analiza e detajuar mbi mosngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit nga SUADA, duke përcaktuar shkaqet dhe masat që parashikohen për adresimin e kësaj çështjeje:

a) Buxhet i pamjaftueshëm. Sporteli unik nuk ka financim të mjaftueshëm që të mbulojë plotësimin e objektivave;

b) Mungesa e burimeve alternative të financimit. SUADA nuk ka mekanizma për të gjeneruar të ardhura shtesë përveçse të ardhurave nga tarifat për përdorimin e të drejtës së autorit. Mungojnë projekte të mbështetura nga donatorë të huaj si BE, UNESCO, Organizata ndërkombëtare që mbështesin mbrojtjen e të drejtave të autorit;

c) Kostoja e lartë për ngritjen dhe mirëmbajtjen e rrjetit të zyrave;

i. Shpenzimet e infrastrukturës. Ngritja e zyrave të reja rajonale kërkon investime për hapësira, teknologji, dhe pajisje të nevojshme;

ii. Shpenzimet operative.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar**.

**Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

## **2.2 Për nënpyetjen: A ka qenë efektiv procesi i mbikëqyrjes së administrimit kolektiv?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit funksionon me strukturë jo të plotë dhe ka mungesë kapacitetesh institucionale. Kjo ka shkaktuar mbingarkesë pune në përmbushjen e detyrave funksionale dhe mosrealizimin në kohë të tyre. Për rrjedhojë procesi i mbikëqyrjes të aktivitetit të agjencive të administrimit kolektiv, ka qenë jo efektiv.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të plotësojë organikën e miratuar për strukturën e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Nëpërmjet urdhrin nr. 37, datë 19.9.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, është miratuar struktura e re e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, si pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Referuar kësaj strukture, DDA është në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ka në përbërje 8 punonjës.

Aktualisht, nëpërmjet procedurave të Departamentit të Administratës Publike janë plotësuar vendet vakante të Drejtorisë për të Drejtat e Autorit. Duke marrë në konsideratë detyrat e reja që i shtohen Drejtorisë për të Drejtat e Autorit nëpërmjet ndryshimeve të reja ligjore dhe zbatimit të detyrave dhe sfidave të reja për mbrojtjen e të drejtave të autorit, është propozuar shtimi i strukturës së kësaj drejtorie gjatë procesit të vlerësimit të kapaciteteve të strukturave për integrimin evropian (CAF) dhe në projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për të drejtat e autorit.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar**.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe pse ka lënë rekomandime për ndryshimet statutores të AAK-ja “A”, statuti i së cilës nuk përputhet me licencën e dhënë nga Ministria e Kulturës, nuk ka marrë masat e duhura ligjore për ta finalizuar këtë proces. Kjo shkelje ligjore e konstatuar nga DDA-ja në raportet e saj të monitorimit, ka mbetur në kuadrin e rekomandimeve, pa propozuar ndonjë masë administrative.

**2.1 Gjetje nga auditimi:** DDA-ja nuk ka verifikuar dhe mbikëqyrur kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtës së autorit, për zbatimin e kriterit kohor të njoftimit, që duhet t’i bëhet çdo mbajtësi të kësaj të drejte, mbi të drejtën e zgjidhjes së kontratës së autorizimit.

**2.2 Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ për pezullim, apo heqje licence të aktivitetit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave edhe pse janë konstatuar shkelje dhe parregullsi të përsëritura. Ministria e Kulturës ka kryer ripërtëritje licence me kusht, për agjencitë “A” dhe “A”, në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

**2.1Rekomandimi:** Ministria e Kulturës:

- t’i kërkojë AAK -së “A”, fillimin e procedurës së ndryshimit të statutit, në përputhje me licencën;
- të rishikojë kushtet e kontratave të lidhura nga AAK-të me mbajtësit e të drejtave;
- për të gjitha AAK-të tek të cilat janë konstatuar shkelje ligjore dhe parregullsi të përsëritura, të fillojë procedurën për pezullim, apo heqje licence.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Përmes urdhrorit nr. 1047, datë 2.12.2024, të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, subjektit “A” i është ripërtëritur licenca në fushën e të drejtave të autorit për veprat letrare, artistike dhe shkencore në tërësi. Në relacionin e përgatitur në procedurën për ripërtëritjen e licencës subjektit “A” i janë konsideruar vetëm kontratat në fuqi dhe i janë rekomanduar përditësimi i kontratave të cilave i ka përfunduar afati.

DDA i ka kërkuar reflektimin e statutit në bazë të rekomandimeve të KLSH-së, agjencisë së administrimit kolektiv “A”, në raportin e monitorimit nr. 1623/9 prot., datë 7.7.2023. “A” ka përcjellë reflektimin e statutit përmes shkresës nr. 1830 prot., datë 13.4.2023.

Megjithatë, kjo pikë nuk gjen zbatim me ripërtëritjen e licencës së “A”, pasi arsye për ndryshimin e statutit ishte se “A” gëzonte licencë vetëm për kompozimet muzikore me ose pa tekst, ndërsa në statut ishte për një kategori veprash më të gjerë.

Me ripërtëritjen e licencës, “A” administron të drejtat të autorit për veprat letrare, artistike dhe shkencore në tërësi. Kjo, për arsye sepse asnjë subjekt tjetër nuk i përfaqëson të drejtat e tyre. Kjo bën të mundur që autorët e veprave letrare të përfitojnë nga vendimi i vitit 2023 për kopjen private por edhe autorët e veprave origjinale të artit pamor për të drejtën e rishitjes.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës, nuk është ngritur Bordi i Arbitrazhit, i cili shërben si organ kolegjal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, që janë grupet e interesit të drejtave të autorit.

**3.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, të marrë masa për ngritjen e Bordit të Arbitrazhit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve.

**Menjëherë**

**Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Pavarësisht rëndësisë dhe rekomandimit për ngritjen e Bordit të Arbitrazhit vlerësojmë se për natyrën e kompetencave të këtij organi, kriteret e vendosura në ligj e bëjnë të pazbatueshëm ngritjen e tij. Pika 3, e nenit 161 e ligjit përcakton se arbitrimi është i përbërë nga 20 anëtarë emëruar për 3 vjet me eksperiencë jo më të vogël se 10 vjet. Në vijim të këtij rekomandimi, DDA ka shqyrtuar mundësinë për të ndërhyrë me ndryshime ligjore përsa ju përket kriterëve.

Edhe pse ndryshimet ligjore janë të pafinalizuara sqarojmë shkurtimisht fokusin e punës, në mënyrë të përgjithshme:

- Arbitrat pjesë e Bordit do të përzgjidhen nga lista e vënë në dispozicion nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.
- Arbitrat do të zgjidhen në një mënyrë që pavarësia dhe paanësia e tyre të jenë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe të kenë ekspertizën e duhur në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to dhe në të drejtën civile të paktën 5 vite.
- Procedura e përzgjedhjes së arbitrave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i pazbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e të Drejtës së Autorit në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të të Drejtës së Autorit, nuk ka mbajtur procesverbale për dy mbledhjet e zhvilluara nga ky këshill.

**4.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masat për monitorimin e aktivitetit të Këshillit Kombëtar, për të Drejtën e Autorit dhe të dokumentojë me procesverbale, çdo mbledhje të zhvilluar.

**Menjëherë**

**Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

KKDA-ja aktualisht nuk është e formuar. Brenda muajit janar 2025, DDA do të ndjekë procedurën për formimin e KKDA-së, në vijim edhe të sqarimit në rekomandimin 9, në këtë material.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i pazbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**3. Për pyetjen e auditimit: A ka funksionuar koordinimi dhe inspektimi ndërmjet DDA, AMA dhe ISHMT?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Paqartësia e kompetencave institucionale ndërmjet subjekteve: Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e së të drejtës së autorit, ka sjellë koordinim të pamjaftueshëm të veprimeve të tyre, për respektimin e kësaj të drejte.

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, të marrin masa për të bashkërenduar, veprimet ndërinstitucionale, për garantimin e procesit të respektimit të së drejtës së autorit.

**Menjëherë**

### **Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit**

Kjo pikë është një veprimtari e cila është e vazhdueshme dhe gjithmonë në zhvillim. DDA ka deleguar një përfaqësues në cilësinë e anëtarit në komisionin e ankimimit në ISHMT për shqyrtimin e masave administrative për shkeljen e të drejtës së autorit. Ky komision mblidhet me ndryshimet e fundit të rregullores së brendshme të ISHMT dy herë në muaj.

Në lidhje me këtë çështje është kërkuar edhe zhvillimi i një takimi tjetër më datë 17.12.2024 me përfaqësues të AMA dhe ISHMT. Informacion më i detajuar është vënë në dispozicion në rekomandimin 3 të këtij dokumenti.

Për sa më sipër, lutemi gjeni bashkëlidhur të gjithë materialet sipas tabelës në shtojcën 1, në zbatim të rekomandimeve të grupit auditues referuar raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

### **Përgjigja e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut:**

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut në bazë të rekomandimeve sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ka vazhduar zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Ministrisë së Kulturës (Drejtorinë e të Drejtës së Autorit) si dhe i është drejtuar Autoritetit të Mediave Audiovizive me shkresën Nr. 5640 prot. Datë: 19.12.2024, për të nënshkruar memorandum bashkëpunimi.

1. Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Ministrisë së Kulturës (Drejtorinë e të Drejtës së Autorit) Nr. 3786 prot. Datë: 05.10.2022.
2. Propozim për nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

### **Përgjigja e Autoritetit të Mediave Audiovizive:**

Nga ana e AMA-s gjatë kësaj periudhe nuk janë ndërmarrë iniciativa ligjore lidhur me “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit” duke qenë se iniciativa ligjore për këtë fenomen nis nga MEKI si Ministria përgjegjëse. AMA ka vijuar procesin e punës duke u përqendruar në luftën kundër piraterisë dhe cënimit të të drejtave të transmetimit duke e diktuar procesin me kuadrin ligjor institucional siç është Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së**

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

Në vijim të Projektraportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara nuk janë paraqitur observacione lidhur me Akt-Verifikimet nr. 1, nr.2 dhe nr. 3, datë 16.01.2025 të mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat nr. 445/15 prot., nr. 445/14 dhe nr. 445/19 prot., datë 19.12.2023, konstatohet se një pjesë e masave është e pazbatuar, e zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

#### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**Për pyetjen audituese: 1 A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?** (Trajtuar më hollësisht në fq.19-29 të Raportit Përfundimtar).

**1. Gjetje nga auditimi:** Kuadri rregullator për të drejtën e autorit<sup>6</sup>, nuk është përafuar me direktivat e BE-së<sup>7</sup>:

- Ministria e Kulturës, nuk ka propozuar hartimin e marrëveshjeve në fushën e të drejtës së autorit lidhur me Aderimin në dy traktate, Traktatin e Marakeshit “Për personat me dëmtime në shikim”, planifikuar për vitin 2017 dhe Traktatin e Pekinit “Mbi veprat audiovizuale”<sup>8</sup>, planifikuar për vitin 2018.

-Ka përafuar pjesërisht 2 direktivat të BE-së lidhur me, koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore dhe për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi - territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm.

**1.1 Gjetje nga auditimi:** Kriteret e vendosura në pikën 1 të nenit 135 të ligjit krijojnë kushte për monopolizim të tregut, duke u bërë pengesë për hyrjen në treg të agjencive të reja. Një shoqatë përfaqësuese autorësh e cila plotëson më mirë kushtet e nenit 133 të ligjit për të qenë e licencuar si agjenci administrimi kolektiv, mund të mos plotësojë kushtet e nenit 135 të ligjit, meqë nuk kanë arritur akoma një bashkëpunim me agjencitë simotra.

**1.2 Gjetje nga auditimi:** Referuar pikës 6, të nenit 151 të Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, lidhur me llogaritjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve, vlerësohet se ka boshllëk ligjor, pasi nuk përcaktohet afati kohor i shpërndarjes. Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve së paku një herë në vit nga AAK-të ka sjellë problematika lidhur me këtë proces.

**1.3 Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit nuk kanë miratuar/hartuar aktet nënligjore për të drejtat e autorit, brenda afateve ligjore të përcaktuara. Në mungesë të tyre, aktiviteti i drejtorisë përgjegjëse është jo efektiv.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masat për miratimin e akteve nënligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian për:

-rishikimin e llogaritjes dhe shpërndarjes së shpërblimeve duke përcaktuar një afat të përshtatshëm për shpërndarjen e tyre;

-krijimin e bazës së të dhënave dhe elementët e regjistrit për të drejtën e autorit, për kompensimin e veprave pa autor, si dhe udhëzimin për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtarinë e sportelit unik;

-rishikimin e kriterëve të përfaqësimit për administrimin e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut.

*Brenda vitit 2025*

<sup>6</sup> Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

<sup>7</sup> Direktivën (BE) 2019/789 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 prill 2019 dhe Direktivën (BE) 2019/790 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 17 prill 2019.

<sup>8</sup> SKPI 2016-2020 fq. 21

**2. Gjetje nga auditimi:** Legjislacioni aktual për të drejtën e autorit krijon kushte për mbivendosje kompetencash, lidhur me monitorimin/ inspektimin dhe zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to sepse nga institucionet përgjegjëse nuk janë propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore mbi procedurat e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet ex-officio (në terren), inspektimet për tregtimin on line, procedurat e bllokimit dhe shkatërrimit të mallrave pirate dhe të falsifikuara, koordinimin ndër-institucional duke rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit, ku të përcaktohen fushat e përgjegjësisë dhe të kompetencave përkatëse.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive, të marrin masat për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe të rishikojnë/nënshkruajnë marrëveshjet e bashkëpunimit, lidhur me garantimin e mbrojtjes të së drejtës së autorit.

*Brenda vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar se, që nga viti 2017, nuk ka një marrëveshje gjithëpërfshirëse të përditësuar, midis shoqatave të përdoruesve dhe agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit. Procesi i negociimit për arritjen e saj ka dështuar, dhe nuk ka asnjë kërkesë nga aktorët e legjitimuar, pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtën Autorit, për rishikimin e metodologjisë dhe masës së shpërblimit të tarifave për mbajtësit e të drejtave. Kuadri ligjor aktual, nuk ofron asnjë mekanizëm për zgjidhjen e këtij ngërçi.

**3.1 Gjetje nga auditimi:** Neni 146 i Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, është në kundërshtim me aktet ligjore, sepse:

- tarifat e shërbimeve nuk përcaktohen me urdhër ministri, por me akte nënligjore të niveleve më të larta;
- sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 27.06.2012, i ndryshuar, anëtarët e KKDA marrin shpërblim për çdo mbledhje.
- KKDA gjatë periudhës 2019-2022 ka zhvilluar vetëm dy mbledhje, në moszbatim të detyrimit ligjor.

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të propozojë, rishikimin e akteve nënligjore lidhur me mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, si dhe krijimin e një mekanizmi për ndërhyrjen e tij në procesin e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit.

*Brenda vitit 2025*

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**Për pyetjen audituese : 1 A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2020-2022 nuk ka pasur strategji kombëtare, për të drejtën e autorit. Statusi që i jepet Drejtorisë së të Drejtës së Autorit nga Strategjitet e Pronësisë Intelektuale, nuk është në raport me përcaktimet e bëra nga ligji, mbi rolin dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie, sepse e trajton këtë drejtori si një institucion dytësor për nga rëndësia.

-DDA-ja nuk harton një strategji të vetën, të dedikuar për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe garantimi i kësaj të drejte nuk parashikohet as në Strategjinë e Ministrisë së Kulturës, duke lënë jashtë fokusit të saj, rolin dhe përgjegjësinë e saj.

Propozimi për bashkimin e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale, nuk lidhet me objektin e aktivitetit të DDA-së, për faktin se veprimtaria funksionale e kësaj drejtorie, është e drejta e autorit.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës si institucion përgjegjës në fushën e të drejtës së autorit, të krijojë një grup pune për rishikimin e dokumenteve politikë si dhe vlerësimin e mundësisë së hartimit të një strategjie të dedikuar për të drejtën e autorit, sipas ligjit që e sanksionon këtë të drejtë.

*Brenda vitit 2025*

**Për pyetjen audite: 2 A ka qenë efektiv procesi i administrimit të së drejtës së autorit?**

**Nënpyetja 2.1:** Si ka funksionuar mekanizmi i ngritur për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit? (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-42 të Raportit Përfundimtar )

**1. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës ka rilicencuar agjencinë e administrimit kolektiv “A”, në muajin gusht të vitit 2021, pa evidentuar shlyerjen e detyrimeve financiare prej 6,7 milion lekë të kësaj agjencie në fondin special të Ministrisë së Kulturës, kusht detyrues në Urdhrin<sup>9</sup> e ministrit “Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A”. Nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit pranë kësaj ministrie, nuk dokumentohet shlyerja e këtij detyrimi financiar.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar detyrimet e prapambetura financiare të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve duke plotësuar një databazë të dhënash financiare.

*Brenda vitit 2025*

**2. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës nuk ka çelur një llogari të dedikuar, e cila të përdoret posaçërisht për krijimin e fondit special, ku duhet të depozitohen shumat e pashpërndara nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, mbajtësve të të drejtave të autorit.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të krijojë Fondin Special, ku të depozitohen tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, duke çelur një llogari të dedikuar.

*Brenda vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në kushtet e ndryshimeve të përfaqësuesve të administrimit të të drejtave të autorit, aktorëve të përfshirë, numrit të shtuar të përdoruesve, kategorive të të drejtave të paparashikuara më parë, konstatohet se nuk ka pasur një rishikim të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit që nga viti 2017, nga grupet e interesit. Drejtoria për të Drejtën e Autorit, nuk ka bërë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, si dhe nuk ka ndërgjegjësuar grupet e interesit mbi rëndësinë e saj.

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të bëjë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të së drejtës së autorit dhe ta bëjë objekt konsultimi për grupet e interesit.

*Brenda vitit 2025*

**4. Gjetje nga auditimi: SUADA:**

-nuk bën transparente kriteret e zbatuara nga ana e saj mbi përzgjedhjen e subjekteve të cilët njoftohen zyrtarisht për t’u pajisur me autorizimin e të drejtës së autorit;

<sup>9</sup> Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”A” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve tveprave artistike dhe letrare”

-gjatë periudhës 2019-2022, ka ngritur 10 akt-padi ndaj shkelësve të së drejtës së autorit, pra me një mesatare prej vetëm 2,5 shkelje të pretenduara të kësaj të drejte në çdo vit.

-mbetet larg objektivit të gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;

-nuk ka realizuar ngritjen e rrjetit të zyrove të përfaqësimit, me të paktën një zyrë në çdo qark.

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit t'i kërkojë Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit, të bëjë transparente:

-kriteret e zbatuara nga ana e saj, në përzgjedhjen e subjekteve që njofton zyrtarisht, për t'u pajisur me autorizim;

-mënyrat e gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;

-një analizë mbi mosngritjen e rrjetit të zyrove të përfaqësimit nga SUADA-s.

*Brenda vitit 2025*

**Për pyetjen audituese: 2 Nënpyetja 2.2** A ka qenë efektiv procesi i mbikëqyrjes së administrimit kolektiv?  
(Trajtuar më hollësisht në faqet 43-48 të Raportit Përfundimtar )

**1. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe pse ka lënë rekomandime për ndryshimet statutare të AAK-ja "A", statuti i së cilës nuk përputhet me licencën e dhënë nga Ministria e Kulturës, nuk ka marrë masat e duhura ligjore për ta finalizuar këtë proces. Kjo shkelje ligjore e konstatuar nga DDA-ja në raportet e saj të monitorimit, ka mbetur në kuadrin e rekomandimeve, pa propozuar ndonjë masë administrative.

**2.1 Gjetje nga auditimi:** DDA-ja nuk ka verifikuar dhe mbikëqyrur kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtës së autorit, për zbatimin e kriterit kohor të njoftimit, që duhet t'i bëhet çdo mbajtësi të kësaj të drejte, mbi të drejtën e zgjidhjes së kontratës së autorizimit.

**2.2 Gjetje nga auditimi:** Ministria e Kulturës nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ për pezullim, apo heqje licence të aktivitetit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave edhe pse janë konstatuar shkelje dhe parregullsi të përsëritura. Ministria e Kulturës ka kryer ripërtëritje licence me kusht, për agjencitë "A" dhe "A", në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës:

- t'i kërkojë AAK -së "A", fillimin e procedurës së ndryshimit të statutit, në përputhje me licencën;

- të rishikojë kushtet e kontratave të lidhura nga AAK-të me mbajtësit e të drejtave;

- për të gjitha AAK-të tek të cilat janë konstatuar shkelje ligjore dhe parregullsi të përsëritura, të fillojë procedurën për pezullim, apo heqje licence.

*Brenda vitit 2025*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës, nuk është ngritur Bordi i Arbitrazhit, i cili shërben si organ kolegjal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, që janë grupet e interesit të drejtave të autorit.

**2.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, të marrë masa për ngritjen e Bordit të Arbitrazhit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve.

*Brenda vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e të Drejtës së Autorit në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të të Drejtës së Autorit, nuk ka mbajtur procesverbale për dy mbledhjet e zhvilluara nga ky këshill.

**3.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masat për monitorimin e aktivitetit të Këshillit Kombëtar, për të Drejtën e Autorit dhe të dokumentojë me procesverbale, çdo mbledhje të zhvilluar.

*Brenda vitit 2025*

**Për pyetjen audituese: 3 A ka funksionuar koordinimi dhe inspektimi ndërmjet DDA, AMA dhe ISHMT?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Paqartësia e kompetencave institucionale ndërmjet subjekteve: Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e së të drejtës së autorit, ka sjellë koordinim të pamjaftueshëm të veprimeve të tyre, për respektimin e kësaj të drejte.

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, të marrin masa për të bashkërenduar, veprimet ndërinstitutionale, për garantimin e procesit të respektimit të së drejtës së autorit.

*Brenda vitit 2025*

Në vijim të Projektraportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara nuk janë paraqitur observacione lidhur me Akt-Verifikimet nr. 1, nr.2 dhe nr. 3, datë 16.01.2025 të mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.
---

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Aneksi Nr. 1**  
**Përmbledhëse e masave sipas llojit.**

**PËR AUDITIMIN ME TEMË: “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”**

**Në 000/lekë**

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuar											
		Nr.	Vler a lekë	N r.	Vl era	Nr.	Vl era	Nr.	Vl era	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										N r.	Vl era	Nr.	Vl era	N r.	Vl era	Arkë tuar	Mb etja	N r.	Vl era	N r.	Vl era
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ	3		3		-		100 %				1		2							
2	Masa organizative	13	-	13	-	-	-	100 %		4		3		4				2			
3	Masa shpërblim dëmi																				
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve ....																				
6	Masa disiplinore																				
7	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>		<b>16</b>	<b>-</b>	<b>16</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>100 %</b>		<b>4</b>		<b>4</b>		<b>6</b>				<b>2</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>